

Sqarime

Nënfinancime – Thirrje për propozime

Projekti “SOCIETIES 2 Mbështetje e OSHC në Shprehite Teknike, Përfshirjen e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Standardet e BE në Ballkanin Perëndimor, faza e 2-të” është miratuar për financim nga Bashkimi Evropian, i përfaqësuar nga Komisioni Evropian.

**Përgjigje ndaj pyetjeve të ngritura nga aplikuesit potencialë për financim
Gjatë sesioneve informuese dhe pyetjeve të marra me e-mail
Deri më datë 30 tetor 2020.**

Pyetje 1	A mund të aplikojnë për grante shoqatat sportive?
Përgjigje 1	Jo, vetëm organizatat e shoqërisë civile.
Pyetje 2	A duhet të renditen kostot indirekte?
Përgjigje 2	Jo, vetëm shuma që është deri në 7% të kostove direkte.
Pyetje 3	Si mund ta vërtetojmë përvojën e punës me persona me aftësi të kufizuara?
Përgjigje 3	Në formularin e aplikimit gjendet një pjesë që i dedikohet përshkrimit të aplikuesit dhe punës së tij me personat me aftësi të kufizuara. Jeni gjithashtu të lutur të përfshini linket e disponueshme dhe informacionin e nevojshëm.
Pyetje 4	A mbështet thirrja aksione që synojnë përfshirjen sociale të personave me aftësi të kufizuara në arte?
Përgjigje 4	Po, me kusht që ato të kenë dimensionin e përfshirjes sociale.
Pyetje 5	A ekziston mundësia e konsultimeve gjatë shkrimit të project-propozimit?
Përgjigje 5	Ekipi i SOCIETIES 2 mund të ofrojë mbështetje teknike sa i takon dokumentacionit të kërkuar dhe mund të japë përgjigje brenda kufijve të objektivitetit dhe aksesit të drejtë për të gjithë aplikuesit potencialë. Ajo nuk mund t'u japë përparësi një a më shumë aplikuesve përmes dhënies së mbështetjes shtesë.
Pyetje 6	A kualifikohet për thirrjen një organizatë që punon me personat me aftësi të kufizuara, por nuk është themeluar nga personat me aftësi të kufizuara?
Përgjigje 6	Po. Megjithatë, aplikuesi duhet të vërtetojë përvojën e vet në punën në fushën e aftësisë së kufizuar.
Pyetje 7	A mund të aplikojmë si individë?

Përgjigje 7	<p>Jo. Thirrja është e hapur për OSHC vendase bazë të cilat merren ekskluzivisht me asistimin/punën me personat me aftësi të kufizuara dhe/ose probleme të shëndetit mendor. Me qëllim kualifikimin për financim, aplikuesi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të jetë person juridik; - të mos jetë fitimprurës; - të jetë OSHC bazë e apo që punon me persona me aftësi të kufizuara.
Pyetje 8	A mund të aplikojmë si nismë qytetare e përbërë nga 3 a më shumë persona?
Përgjigje 8	<p>Jo. Thirrja është e hapur për OSHC bazë vendase të cilat merren ekskluzivisht me asistimin/punën me personat me aftësi të kufizuara dhe/ose persona me probleme të shëndetit mendor. Me qëllim kualifikimin për financim, aplikuesi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të jetë person juridik; - të mos jetë fitimprurës; - të jetë OSHC bazë e apo që punon me persona me aftësi të kufizuara dhe/ose persona me probleme të shëndetit mendor;
Pyetje 9	A mund të përdoren fondet e përfituara nga këto grante për të plotësuar disa aktivitete brenda një projekti tjetër?
Përgjigje 9	Grantet e disponueshme në bazë të kësaj thirrjeje duhet të përdoren për projekte, grupe aktivitete me objektiva konkrete dhe rezultate përmes asistimit/punës me persona me aftësi të kufizuara.
Pyetje 10	A është i kualifikueshëm aplikimi për aktivitete psiko-sociale në nivel shkollor?
Përgjigje 10	Mbështetja psiko-sociale mund të jetë aktivitet që planifikohet me projektin. Grupet e synuara janë persona me aftësi të kufizuara dhe/ose persona me probleme të shëndetit mendor. Grupe të synuara mund të jenë fëmijët, të rinjtë, të rriturit.
Pyetje 11	A kërkohet që përfituesit të jenë vetëm persona me aftësi të kufizuara apo me probleme të shëndetit mendor, a mund të jenë përfituesit pjesë e komunitetit rom dhe egjiptian ashtu si edhe përfituesit që përbëjnë raste sociale?
Përgjigje 11	<p>Qëllimi i thirrjes është</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mbështetja dhe fuqizimi i shërbimeve mbështetëse me bazë komunitare dhe bizneseve sociale të menaxhuar nga OSHC, duke inkurajuar kështu përfshirjen sociale të personave me aftësi të kufizuara dhe ata me probleme të shëndetit mendor. Grupet e synuara janë personat me aftësi të kufizuara.
Pyetje 12	A lejohet stimulimi për ekonominë sociale apo dhënia e financimeve për individë?

Përgjigje 12	Nuk lejohet dhënia e granteve për individë.
Pyetje 13	A lejohet mbështetja psiko-sociale apo ndihma e psikologut?
Përgjigje 13	Mbështetja psikologjike apo psiko-sociale mund të jetë një aktivitet i parashikuar në projekt.
Pyetje 14	A lejohet ndihma e përfituesve me pajisje higjieno-sanitare apo ushqime?
Përgjigje 14	Kjo thirrje nuk mund të përdoret për planifikimin e projekteve me qëllim të vetëm ndihmën me artikuj higjienikë dhe ushqimorë për përfituesit.
Pyetje 15	A mund të jenë partnerët tanë institucione publike dhe qeveritare (qendër për punë sociale, etj.)?
Përgjigje 15	Institucionet publike dhe qeveritare (qendra për punë sociale, etj.) nuk mund të jenë partnerë në projekt. Institucionet publike dhe qeveritare (qendra për punë social , etj.) mund të jenë ortakë në projekt. Aplikuese të projektit dhe partnerë mund të jenë vetëm OSHC.
Pyetje 16	Sa është numri minimal i bashkive që duhet të mbulohen nga një projekt?
Përgjigje 16	Duhet që me anë të projektit të mbulohet të paktën një bashki.
Pyetje 17	Kur thoni 'Kopje e bilancit dhe deklarata e të ardhurave për vitin e fundit fiskal (2019)' a keni parasysh formën me CD?
Përgjigje 17	Një kopje e bilancit dhe deklarata e të ardhurave për vitin e fundit fiskal (2019) duhet të paraqitet me aplikimin.
Pyetje 18	A janë të pranueshme aktivitetet sportive për persona me aftësi të kufizuara?
Përgjigje 18	Po, me kusht që ato të kenë një dimension përfshirjeje sociale.
Pyetje 19	A mund të jetë partnere në projekt një organizatë të rinjsh, që punon edhe me persona me aftësi të kufizuara, në rast se aplikuese është një shoqatë e personave me aftësi të kufizuara?
Përgjigje 19	Po, sidomos për shkak se aplikuesi do të jetë shoqatë e personave me aftësi të kufizuara. Qendra e të rinjve në vijim do të duhej të vërtetonte përvojën e saj në punën me persona me aftësi të kufizuara.
Pyetje 20	A është i kualifikueshëm aktiviteti i rehabilitimit profesional të personave me aftësi të kufizuara në sektorin bujqësor?
Përgjigje 20	Po, rehabilitimi profesional është një ndër të drejtat themelore të personave me aftësi të kufizuara dhe mund të konsiderohet shërbim shoqëror.
Pyetje 21	Si do ta trajtojmë TVSH-në nëse nuk është kosto e kualifikueshme?

Përgjigje 21	TVSH-ja nuk është kosto e kualifikueshme. Nëse projekti juaj miratohet, do të nisim një procedurë të përbashkët përjashtimi nga TVSH. Pas kësaj, të gjitha blerjet dhe kostot e tjera duhet të jenë pa TVSH.
Pyetje 22	A mund të aplikojë një kompani që ka punonjës dhe persona me aftësi të kufizuara?
Përgjigje 22	Jo, aplikimi u lejon vetëm atyre bizneseve sociale themeluesi i të cilave është një organizatë e shoqërisë civile që asiston/punëson persona me aftësi të kufizuara.
Pyetje 23	A ka mundësi që implementimi i aksionit të propozuar të fillojë më vonë dhe jo domosdoshmërisht menjëherë pas nënshkrimit të kontratës?
Përgjigje 23	Fillimi i projektit do të përcaktohet me kontratë. Në kontratë mund të përcaktohet një fillim i mëvonshëm prej 6 muajsh pas nënshkrimit të kontratës si afat maksimal i fillimit të implementimit të projektit. Në rastet kur organizatat duan ta shtyjnë fillimin e implementimit të projektit për një periudhë më të gjatë, ato duhet të japin shpjegime.
Pyetje 24	A mund ta plotësojmë formularin e aplikimit në anglisht? Unë përdor një program me diktim zëri për shkak të aftësisë sime të kufizuar dhe është më e lehtë për mua që të shkruaj në anglisht.
Përgjigje 24	Formularët e aplikimit janë bërë në gjuhën e vendit prandaj dokumentet e paraqitura do të duhej të ishin gjithashtu në këtë gjuhë. Megjithatë, nëse nuk është e mundur të aplikohet në gjuhën e vendit për shkak të programit që përdoret, do të pranohet aplikimi në anglisht.
Pyetje 25	Kemi një organizatë partnere. A duhet që organizata partnere të paraqesë të njëjtat dokumente regjistrimi si ato të aplikuesit kryesor?
Përgjigje 25	Organizatat partnere duhet të plotësojnë të njëjtat kritere si ato të aplikuesit dhe duhet të paraqesin formularin e deklaramit.
Pyetje 26	UMHNK aktualisht po implementon një projekt financiarisht të mbështetur nga Bashkimi Evropian, përmes programit IPA II, në kuadrin e një programi veprimi shumëvjeçar të Bashkimit Evropian dhe Malit të Zi për punësim, arsim dhe mbrojtje sociale, në kuadrin e thirrjes Mbështetje për Ofrimin e Shërbimeve të Mbrojtjes Sociale dhe të Fëmijëve dhe nesh sipas marrëveshjes; interesohemi nëse mund të aplikojmë për ftesën tuaj publike.
Përgjigje 26	Thirrja është e hapur për organizatat e shoqërisë civile që ndihmojnë/punojnë me persona me aftësi të kufizuara. Pjesëmarrja juaj në programin e lartpërmendur nuk përjashton mundësinë e pjesëmarrjes në këtë thirrje.
Pyetja 27	A është e mundur të llogaritet si bashkëfinancim pjesa e pagës që subvencionohet nga Fondi për Rehabilitimin Profesional dhe Punësimin e

	Personave me Aftësi të Kufizuara, kur projekti punëson persona me aftësi të kufizuara?
Përgjigje 27	Po.
Pyetje 28	Interesohemi nëse mbështesni aktivitete online dhe blerjen e tableteve për përfituesit.
Përgjigje 28	Thirrja mbështet shërbime që synojnë promovimin e përfshirjes sociale të personave me aftësi të kufizuara. Lejohet prokurimi i pajisjeve.
Pyetje 29	Lidhur me koordinatorin dhe asistentin e projektit. A nuk duhet që pagesat e tyre të kalojnë 25% të buxhetit të projektit?
Përgjigje 29	Kostot e pagave për koordinatorin dhe asistentin e projekteve kualifikohen nëse ata përfshihen drejtpërdrejt në implementimin e aktiviteteve. Këto kosto nuk kufizohen nga një përqindje e caktuar.